



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Sekretari i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D' Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, ____/____/2018

NJOFTIM

**PËR RISHPALLJEN E REKRUTIMIT TË NJË (1) EKSPERTI NË FUSHËN E
MONITORIMIT TË KUFIJVE DHE MBROJTJES SË REFUGJATËVE**

Në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së rishikuar, të nënshkruar me Zyrën e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), në kuadër të projektit "Refugjatët dhe Azilkërkuesit në vendet e Evropës Jug-lindore", institucioni i Avokatit të Popullit kërkon të rekrutojë një ekspert në fushën e monitorimit të kufijve dhe mbrojtjes së refugjatëve, për periudhën kohore nëntor-dhjetor 2018, me mundësi shtyrje (bazuar në performance) edhe për 12 (dymbëdhjetë) muaj të tjerë.

Objektivat dhe aktiviteti

Objektivat e projektit kane të bëjnë me:

- a. promovimin dhe monitorimin e aksesit në territor dhe në procedurat e azilit për azilkërkuesit dhe refugjatët e identifikuar në kufijtë shqiptarë,
- b. rritjen e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse lidhur me azilin dhe të drejtat e njeriut.
- c. mbështetje të promovimit të informacionit për refugjatët dhe azilkërkuesit

Këto objektiva do të arrihen përmes aktiviteteve të mëposhtme:

- a. monitorimi sistematik i kufijve
- b. prezenca gjatë procedurave të përzgjedhjes me personat në fjalë
- c. analizë dhe rekomandime në lidhje me procedurat e mësipërme dhe monitorimin e kufirit
- d. raportim i të dhënave në Zyrën Qendrore dhe UNHCR

e. kontribut në hartimin e fletëpalosjeve për refugjatët dhe azilkërkuesit

f. bashkëpunim me aktoret dhe pjesëmarrje në aktivitete/evente të përbashkëta

Kërkesat e veçanta për perzgjedhjen e kandidatëve

Kandidatët që duan të aplikojnë për këtë pozicion, duhet të plotësojnë kriteret dhe procedurat e mëposhtme:

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë;
- Të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtave të njeriut dhe fusha të përafërta. Njohja e legjislacionit shqiptar dhe/ ose akteve ndërkombëtare në fushën e azilit, do të konsiderohet përparësi;
- Të ketë njohje të thellë të gjuhës shqipe dhe angleze, në të folur dhe në të shkruar; njohja e një gjuhe të tretë është e preferueshme
- Të ketë aftësi organizative dhe administrative si dhe veçanërisht aftësi komunikimi;
- Të ketë standarde të larta të integritetit dhe përvojës në trajtimin e informacionit konfidencial
- Të zotërojë automjetet dhe patentë dhe të jetë i/e gatshme për të udhëtuar;
- Të përmbushë afatet, të jetë i/e gatshëm për të punuar fort, edhe gjatë ditëve të pushimit javor, si dhe i/e orientuar drejt arritjes së rezultateve;
- Të ketë fleksibilitet, aftësi të forta adaptimi dhe aftësi për punë në ekip
- Të ketë njohuri të mira kompjuterike në programet Microsoft Word, Excel, si dhe njohuri të sistemeve të Teknologjisë së Informacionit (IT).

Përshkrimi i punës

Detyrat e ekspertit në fushën e monitorimit të kufijve dhe mbrojtjes së refugjateve do të jenë:

- Monitorimi i procedurave të perzgjedhjes.
- Kryerja e intervistave të thelluara me individet.
- Plotësimi i të dhënave të mbrojtjes sipas instrumentit standard të UNHCR-së (Kobo tool box) si dhe raportimi i dëbimeve dhe incidenteve që lidhen me kalimin e paligjshëm të kufirit, si edhe dokumentimi i incidenteve.
- Kryerja në bashkëpunim me stafin e UNHCR-së me seli në Korçë dhe Shkodër, të 3 (tre) vizitave monitoruese në javë në objektet e shqyrtimit të perzgjedhjes.
- Ofrimi i analizave mbi funksionimin e procedurave të perzgjedhjes si dhe rekomandimet se si të përmirësohet zbatimi i tij.
- Pjesëmarrja në tryezat e koordinimit kombëtar dhe seminareve rajonale të organizuara nga UNHCR për të përmirësuar procedurat e perzgjedhjes.
- Të kontribuojë në ndarjen e informacionit, bashkërendimin e punës me aktorë të tjerë, të marrë pjesë në aktivitete dhe evente të lidhura me punën
- Të jetë i/e gatshëm të punojë nën stres, të jetë i/e gatshëm të punojë me fleksibilitet

- Të mbajë marrëdhënie efikase dhe korrekte bashkëpunimi me Policinë e Kufirit dhe Migracionit, dhe aktorëve të tjerë të përfshirë.
- Të ruajë me **rigorozitet konfidencialitetin** në të gjithë aspektet e lidhura me veprimtarinë e punës.
- Të kryejë në kohë të shpejtë, pa vonesa dhe me efikasitet çdo detyrë tjetër që do ti caktohet nga institucioni i Avokatit të Popullit.

Periudha dhe vendndodhja

Afati i rekrutimit do të përfshijë periudhën nëntor-dhjetor 2018, me mundësi zgjatje kontrate edhe për gjatë gjithë vitit 2019, bazuar në performancën që do të ofrohet.

Duke qene se është e domosdoshme kryerja e lëvizjeve të shpeshta në piken kufitare të Kapshticës, ku do të ushtroje funksionet përkatëse të përshkruara me lart, është e nevojshme pasja e patentës dhe e një mjeti në dispozicion. Për këto arsye, është i preferueshëm vendbanimi i personave në Korçë.

Procedurat e Përgjithshme të Aplikimit:

Aplikimi duhet të përmbajë:

- Letër motivimi;
- Curriculum Vitae (CV);
- Kopje të diplomës;
- Kopje të librezës së punës;
- Dëshmi të gjuhës së huaj (nëse ka);
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore

Aplikimet duhet të dërgohen në rrugë elektronike në adresën:

msanxhaku@avokatipopullit.gov.al, ose në zarf të mbyllur duke specifikuar pozicionin në adresën:

Institucioni i Avokatit të Popullit

Blv. “Zhan D’Ark”, nr.2, Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve

Afati

Aplikimet pranohen deri në datë **09.11.2018, ora 16: 30**. Do të shqyrtohen vetëm ato aplikime që mbërrijnë brenda këtij afati. Pas vlerësimit të dokumenteve vetëm kandidatët e suksesshëm do të ftohen për intervistë.